



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Mëqësisht Org. Org. Jedinica Org. Unit	SP-02	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	8655-2/21
Nr. i faqëve Broj. stranica No. pages	-03-	Data. Datum: Date:	24.04.2026
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	20.04.2026
REFERENC-Ë:	25/8655/760/DMM
PËR/ZA/TO:	"Suma Pro" Sh.p.k. Rakaj, Ferizaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 25/8655/760/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për **Refuzimin** e kërkesës së Kompanisë "Suma Pro" Sh.p.k. Rakaj, Ferizaj, për të u pajisur me Pëlqim Mjedisor për Fabrikën për prodhimin e epruvetave dhe kapakëve nga PET në ngastrën kadastrale P-72217071-00214-8 Z.K. Rakaj, Komuna Ferizaj.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa e Kompanisë "Suma Pro" Sh.p.k. Rakaj, Ferizaj, për të u pajisur me Pëlqim Mjedisor për Fabrikën për prodhimin e epruvetave dhe kapakëve nga PET në ngastrën kadastrale P-72217071-00214-8 Z.K. Rakaj, Komuna Ferizaj.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit të bashkëngjitur kërkesës për pajisje me pëlqim mjedisor, Komisioni për VNM konstaton se lënda e dorëzuar ka qenë e kompletuar. Më datën 15.01.2026, Komisioni i ka dërguar Kompanisë njoftimin për organizimin e debatit publik, si dhe konfirmimin për mbajtjen e tij

Në përputhje me Ligjin nr. 08/L-181 për VNM, neni 16, më datën 05.03.2026 është mbajtur debati publik. Nga procesverbali i dorëzuar nga Kompania rezulton se në debat kanë marrë pjesë përfaqësues të Kompanisë, hartuesi i Raportit të VNM-së dhe përfaqësuesi i MMPH-së përmes platformës elektronike, ndërsa nuk është evidentuar pjesëmarrje e qytetarëve.

Faqe 2 nga 3



Pas mbajtjes së debatit publik, në mbledhjen e Komisionit është konstatuar se Kompania ka kryer shkelje të dispozitave ligjore gjatë procedurës së publikimit të njoftimit për organizimin e debatit publik, përkatësisht nuk i është përmbajtur afati të publikimit, i cili, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të jetë jo më pak se 30 ditë para datës së mbajtjes së debatit publik. Publikimi për debat publik nga ana e Kompanisë në gazetën "Epoka e Re" është bërë më 23.01.2026 dhe në ueb-faqen e Komunës së Ferizajt më 26.01.2026, me ç'rast nuk janë respektuar afatet e përcaktuara me Ligjin nr. 08/L-181 për VNM.

Duke marrë parasysh mosrespektimin e afateve ligjore dhe parregullsitë në procedurën e publikimit, MMPH merr vendim të e refuzojë kërkesën për pajisje me pëlqim mjedisor të Kompanisë "Suma Pro" Sh.p.k., Rakaj, Ferizaj, për realizimin e projektit: fabrikë për prodhimin e epruvetave dhe kapakëve nga PET, në ngastrën kadastrale P-72217071-00214-8, Z.K. Rakaj, Komuna e Ferizajt.

Vërejtje: Afati për shqyrtimin e kësaj lënde është tejkalu për shkak të zëvendësimit të Sekretarit të MMPH-së.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimi e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

25/8655/- ZSP/ /26 datë: 14.04.2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Ferizajit
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
9. Arkivit të MMPHI



UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH